



22.03.2017

## KOMUNIKATË PËR MEDIA

### AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT SHPALLI REZULTATET E SHITJEVE PËRMES LIKUIDIMIT Nr. 30

**Prishtinë** – Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) sot në ceremoninë e hapjes së ofertave të shitjeve nr. 30 përmes metodës së likuidimit shpalli çmimet më të larta të ofruara për asetet e ndërmarrjeve shoqërore që ishin në dispozicion për shitje.

Për 59 asete sa ishin në shitje përmes kësaj vale të tenderuar gjithsej u pranuan 88 oferta, dhe vlera e tërësishme e ofertave më të larta ishte 3.986.159 Euro.

Dorëzimi i ofertave nga investitorët, hapja e ofertave dhe publikimi i rezultateve u bënë në mënyrë transparente, para përfaqësuesve të mediave, përfaqësuesve të Odës Ekonomike të Kosovës dhe Odës së Avokatëve të Kosovës si dhe investitorëve të pranishëm, ndërkaq është bërë transmetimi drejtpërdrejt i ceremonisë përmes faqes zyrtare të internetit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit: [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org) si dhe është transmetuar drejtpërdrejt edhe përmes Agjencisë së Lajmeve [www.kosovapress.com](http://www.kosovapress.com), duke mundësuar përcjelljen e ceremonisë edhe për të gjithë qytetarët e interesuar që s'kanë qenë të pranishëm në sallë.

Ceremonia e hapjes së ofertave ka filluar në orën 12:30 dhe është mbajtur në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve, ku edhe është bërë dorëzimi i ofertave nga ofertuesit nga ora 10:00 deri në ora 12:00.

Agjencia Kosovare e Privatizimit, është organ i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe është e shtrirë dhe vepron në të gjithë territorin e vendit. Agjencia ka mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe/ose aseteve investitorëve private-blerësve, ose likuidimin e tyre, gjithnjë përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues dhe pa vonesa.

***Bashkangjitur (në atach) gjeni tabelën me ofertat e pranuar dhe çmimet e ofruara për secilin aset të tenderuar në Shitjen e Aseteve përmes Likuidimit nr.30.***

***Gjithashtu gjeni të bashkangjitura edhe disa fotografi nga ceremonia e mbajtur.***

## FUND